



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No. 02-401-04-2680-24

Nr. i fq. / Br.str. / No.pg. _____

Data / Datum / Date 26.01.2024

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



ZYRA E KRYETARIT

Duke u bazuar në nenin 68 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe paragrafin 4 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, paraqet këtë:

RAPORT

(Strategjia Socio Ekonomike e Komunës së Obiliqit 2023-2027)

Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, nëpërmjet Shefit të Kabinetit, me datë 20.12.2023 ka mbajtur diskutimin publik për dokumentin, “**Strategjia Socio Ekonomike e Komunës së Obiliqit 2023-2027**” me qytetarët e komunës së Obiliqit, diskutimi është mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal, nga ora 13:30.

Gjatë diskutimit ishin prezent, Shefi i Kabinetit, grupi punues për konsultime publike, përfaqësues të OJQ-ve dhe qytetar.

Të pranishëm në këtë diskutim kanë qenë gjithsej 11 pjesëmarrës, prej tyre 3 gra 9 burra.

Prezantimi i “**Strategjisë Socio Ekonomike për Komunën e Obiliqit 2023-2027**”, u bë nga shefi i Kabinetit, Burim Gërguri, i cili fillimisht i falënderoi pjesëmarrësit në këtë takim dhe prezantoi strategjinë para të pranishmëve.

Pas prezantimit kemi pranuar dy (2) kërkesa për informacion.

- **Xhemile Krasniqi** : Këshill që kur të bëhen përrurime në Mazgit, me na ftu edhe neve me qenë prezent aty faleminderit.
- ✓ **Burim Gërguri** : Faleminderit vërejtje me vend në të njëjtën ditë janë përruruar dy salla dhe Dardhishta kërkojmë falje sepse DKA ka bërë ftesat.
- **Ramadan Qunaku** : Kryetar i këshillit lokal Obiliq qendër, ju përgëzoj me përqindjen për realizimin e buxhetit natyrisht është mire mirëpo unë kam disa propozime si provim të parë a ka mundësi që komuna gjegjësisht DKA, me bo një marrëveshje me KEK-un, që

kuadrat që pensionohen të plotësohen me kuadrat që dalin prej shkollës së Obiliqit i kish konvenu edhe ligjit për Obiliqin, nëse shkruhet që mbas 3 viteve sa dalin në pension dhe kishim regjistruar me nxënës nga komuna jonë, nëse ai numër nuk plotësohet nga komuna jonë me ardhë nga vendet tjera, kështu që janë disa gjëra tjera që unë mendoj që ndoshta kishim mund me bo një marrëveshje që faktikisht mi pas kuadrat e gatshme që mbasi të dalin në pension ti kemi kuadrat e gatshme mendoj që kish me qenë mirë, si propozim i dytë për vitet 23/27 a ka mundësi që terrenet e futbollit stadionet që mu zhvendos dhe me i qit poshtë te livadhet ka shkon ka lajthishta ato i ka marr KEK-u stadioni ku është një hapësirë e mirë për komunën. Pika e tret rreth bursave unë jam i mendimit që duhet me qenë një kriter baze nota mesatare.

- ✓ **Burim Gërguri** : Sa i përket bursave, për notën 8 mesatare duhet me dhanë bursë me qenë stimulim me i madhë për studentët që me pas kuadro të mëdha po aj buxhet ka me qenë ma i madh me i mirë, që pragu me qenë mbi noten mesatare 8. Në përgjithësi kjo vlen edhe tek nxënësit edhe tek studentët.


Burim Gërguri : falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Komente të tjera nuk kemi pranuar as në formën me shkrim, diskutimi publik ka përfunduar në ora 15:00.

Pjesë përbërëse e këtij raporti janë:

1. Procesverbali dhe
2. Lista e Pjesëmarrësve.

Obiliq
18.01.2024



Zyrtare përgjegjës për konsultime publike

Festina Preniqi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



DREJTORIA PËR KULTURË RINI DHE SPORT

PROCESVERBAL

Draft-Statuti i Bibliotekës Komunale të Obiliqit

Procesverbal i datës 27.12.2023

Takimi filloi në ora 11:00.

Gjatë diskutimit ishin prezent grupi punues për konsultime publike, përfaqësues të OJQ-ve etj.

Takimin e hapi Rifadije Paloja - shefe për Kulturë në DKRS, e cila i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje siç e ka rendi një fjalim në emër të drejtorisë ju falënderoj që jeni përkushtuar për të ardhur në këtë diskutim publik, si grup që e kemi hartuar Draft statutin e Bibliotekës konsideroj që secili prej jush e dini kronologjinë e bibliotekës ne e kemi traditë. Në vitin 2021 është ndërtuar biblioteka e qytetit e cila si qellim për traget ka studentet nxënësit dhe moshat më të vogla.

Me funksionimi i këtij institucioni u krijua një rend i ri dhe objekti që më herët nuk ka qen.

Në këtë dokument janë të përfshinë disa nene në të cilat pothuajse të gjitha nenet janë të kapshme dhe te realizueshme. Neni i parë rregullohet statusi i bibliotekës dhe veprimtaria, struktura shfrytëzimi dhe transparenca. Konsideroj që e dini çfarë rëndësie ka, dhe vendimet që miraton ju ka referua edhe ligjit për biblioteka dhe si produkt do të hartohet edhe rregullorja dhe i vetdijëson lexuesit ata që janë se si të sillen dhe obligimet ndaj bibliotekës. Është fat i mirë që hapësira e saj është e mirë dhe moderne planifikohen edhe shërbime të tjera tek sektori i të rriturve, i fëmijëve, i trashëgimisë, i punëve të përbashkëta, info bibliobusi. Varësisht se çka kërkohet ne do të themelojmë edhe sektorë të tjerë. Gjithashtu në këtë draft- statut parashihet të ketë edhe drejtuesin, drejtorin e një institucion duhet ta ketë kreun e vet dhe të ardhmen të vendoset sepse është planifikuar dhe është e nevojshme.

Diçka tjetër nuk kisha shtuar nëse ju keni ndonjë pyetje rreth këtij dokumenti. Nëse dikush nga ju doni të bëni pyetje i mirëpresim, ne si grup punues e kemi dërguar këtë dokument edhe në departamentin në ministri se a është hartuar mirë dhe mos rastësisht kemi bërë ndonjë shmang'je pa dashje. Ata me disa vërejtje te vogla na kanë kthyer qe dokumenti është në rregull, sido që të jetë vërejtjet sugjerimet janë të mirëseardhura në kuadër të këtij drafti. Si dokument është edhe pjese e agjendës se kuvendit se çka kanë të plotësojnë që ky dokument të jetë funksional, dhe sugjerimet e juaja janë të mirëseardhura. Harrova me cek se biblioteka ka hapësirën e vet praktikisht e luan rolin e një kabineti informatikë ku hapësira është me kompjuter ku do të digjitalizohet. Jam në kontakt me bibliotekën kombëtare që të na

ndihmojnë në këtë aspekt dhe ju si lexues.

Ajo çka synoj të jete e favorshme dhe e dobishme për komunitetin që lexojnë është bashkëpunimi edhe jashtë trevave kemi kërkesa nga biblioteka e Tiranës po me keqardhje nuk kam përgjigje se pse kjo lidhje nuk është realizuar sepse pesha është shume e madhe. Ky bashkëpunim do të kishte krijuar një bashkëpunim kulturor, dhe jo vetëm kulturor po edhe shpirtëror dhe vëllazëror synoj që duhet të punojmë në bashkëpunime të ngushta jo vetëm me republikën e Shqipërisë po edhe me vende të tjera. Nëse organizimi nuk është në kushte të favorshme mirëpo ka kushte dhe konsideroj që është objekti më i bukur në komunën tone dhe jo vetëm, pres sugjerime dhe komente nga ana juaj!

Hamit Mjeku : Nuk jam njohës mirëpo pika 9 dhe rizgjedhja e shefit çfar është menduar me këtë?

Rifadije Paloja : Pikërisht për këtë qështje objekti kulturor duhet ta ketë një udhëheqës, gjithashtu jam konsultuar me zyrën ligjore dhe burimeve njerëzore. Prandaj ju kam referuar që përzgjedhja të jete në bazë të ligjit në fuqi.

Hamit Mjeku : Te neni 9 zgjedhja e drejtorit që të bëhet nga DKRS-ja të jetë si rekomandim!

Rifadije Paloja : Ne mundemi vetëm me bë kërkesën dhe procedura bëhet nga zyra e personelit. Ne eventualisht mundemi me qen vetëm pjese e komisionit, kështu për menaxhim është zyra e burimeve njerëzore.

Hamit Mjeku : A duhet të propozohet emri për Bibliotekë apo do të emërohet si Biblioteka e Obiliqit.

Rifadije Paloja : Pyetje me vend ndërkaq qa i përket emrit ta ketë një emër të një gruaje si të them të jetë si nje far civilizimi për në të ardhme mirëpo për ne është vetëm biblioteka e qytetit. Është propozim i imi që ta ketë një emër gruaje dhe të jetë nga Obiliqi.

Gent Mjekiqi : Kisha propozuar që mu zgjedh një emër që ka kontribuar në komunën e Obiliqit dhe të ketë një bagazh dhe tjetra të zgjedhja e drejtorit të ketë një përvojë në arsim së paku 5 vjet dhe ndryshe është kur të ketë përvojë e ndryshe pa përvojë.

Rifadije Paloja : Faleminderit që gjithnjë je aktiv dhe ke kontribuar në atë që mendon dhe pothuajse çdo here i ke të qëlluara mirëpo ka qen vetëm një propozim dhe të ketë një bagazh që nesër apo në të ardhmen dhe jo politik mund ta ketë kulturor, shkencor, kështu që do të ketë diskutime publike dhe si propozim është i arsyeshëm. Gjithashtu nuk e di se pse në sheshe nuk ka një emër apo një bust për gruan. Sa i përket drejtorit i referohemi ligjit dhe ta ketë një bagazh dhe kridibilitet të jetë i përgatitur në çdo sferë. Synimet tona të jetë një njeri i përgatitur dhe ta din peshën e një biblioteke dhe ketë fushë. Faleminderit dhe besoj që i ke prek 2 pika të rëndësishme dhe besoj që inventari i nevojshëm për lexues ka më shumë letërsi mirëpo uroj që të ardhmen ta pasurojmë ketë bibliotekë që të kemi me fusha të nevojshme kemi donacion nga UNMIK-u kështu që fushat e juridikut mjekësisë nuk ka literatura pak e hiq mirëpo besoj që do ta mbushim me libra të tjera.

Teuta Grajçevci : A ka lektyra si i kemi i pas edhe ne.

Rifadije Paloja : Po ka mirëpo janë edhe neper shkolla. Besoj që në shkollë me caktu me shku në bibliotekë dhe do te ishte një nismë e mirë që nxënësit mi sjellë 2- 3 herë në bibliotekë për me arrit leximin mendoj që kjo duhet të ketë bashkëpunim në mes të shkollave nxënësve dhe prindërve. Që shumë më mirë me dërgua ne bibliotekë.

Faleminderit për pjesëmarrje dhe ju uroj një fund vitë të mbarë dhe me shumë suksese.

Takimi përfundoi në ora 12:00, me gjithsej 13 pjesëmarrës.

Procesmbajtëse: Majlinda Kutillovci



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIÇIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIČ



LISTA E PJESËMARRËSVE

Debat Publik "Strategjia Socio-Ekonomike e Komunës së Obiliçit 2023-2027"

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Filloi në ora: 13:30

Data: 20.12.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Telefoni	E-mail	Nënshkrimi
1.	Redife Krasniqi	Mazgjtë	044587039	redife72@gmail.com	
2.	Keamile Krasniqi	Mazgjtë	096738338	shqepete.mairajp@com	
3.	Hyd Krasniqi	Mazgjtë	049-713-906		
4.	Rahman Stohini	Pleminë	044-490444		
5.	Ramdan Gumbet	Ohiliq	044/642-512		
6.	Xharr Ibrahim	Milloshëvë	049 116-401		
7.	Ardian Kelmend	Milloshëvë	048-330-173	ardk@kumendi@gmail.com	
8.	Valentina All	Milloshëvë	045-637-483	Valentina@oplus.org	
9.	Syleman Allajev	Ohiliq	044292192	sylla_ami@letuad.com	
10.	Idet Gerasvici	HABE	049-26638		
11.	Luiz Begard	Rekuzave	045/165-100		
12.					
13.					
14.					